



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.7 Regj.Them.
Datë Rregj. 06.04.2021

Nr. 7 VENDIMI
Datë 12.04.2021

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtar: Sokol IBI- (*Relator*)
Gjyqtar: Asim VOKSHI- (*Anëtar*)
Gjyqtare: Esmeralda ÇEKA (XHILI)- (*Anëtare*)
Gjyqtare: Edlira PETRI- (*Anëtare*)
Gjyqtar: Gentian MEDJA- (*Anëtar*)

me sekretare gjyqësore Erjona Torba, sot më datë 12.04.2021, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.7 akti, datë 06.04.2021 që i përket:

- PADITËS:** Partia ``Aleanca Kombëtare``, përfaqësuar në gjykim nga kryetari i saj Z. Krenar Tahiri.
- I PADITUR:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar në gjykim me autorizim me nr. 3579 prot, datë 10.04.2021 nga Z. Erdal Mema dhe Znj. Shila Ballhysa.
- OBJEKTI:** Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e subjektit politik Partia Aleanca Kombëtare në Zgjedhjet Parlamentare të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.
- BAZA LIGJORE:** Neni 152 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i përditësuar, neni 154 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet e fundit të palës paditëse që kërkoi pranimin e padisë, si dhe palës së paditur që kërkoi rrëzimin e padisë,

VËREN:

Se pala paditëse Partia “Aleanca Kombëtare” i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me padinë me objektin e sipërcituar.

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

1. Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020 ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

2. Me vendimin nr. 78, datë 15.2.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është vendosur: *“Të regjistrojë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, “Partia Aleanca Kombëtare”, me Kryetar z. Krenar Tahiri, me shkronjat nistore “P.A.K”.*

3. Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (referuar në vijim edhe si KQZ) verifikoi listat shumëemërore të kandidatëve për deputetë të subjektit politik “Partia Aleanca Kombëtare” dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur.

4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin Nr.139, datë 11.03.2021 ka vendosur:

1. Kthimin për korigjim, sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëemërore të kandidatëve për deputet, të Partisë” Aleanca Kombëtare” për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

2. Dokumentacioni i korigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Sipaspërmbajtjes së vendimit të sipërpërmendur rezulton se janë konstatuar, ndër të tjera edhe mangësitë e mëposhtme:

“1.. Partia “Aleanca Kombëtare” nuk ka paraqitur dokument provues për plotësimin e kërkesave të nenit 68/1 të Kodit Zgjedhor për zotërimin e 1 (një) mandati në Kuvend ose paraqitjen e listave mbështetëse me jo më pak se 5000 zgjedhësve në shkallë kombëtare. ...”.

Ky vendim rezulton të jetë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së.

5.Në vijim të vendimit nr. 139, datë 11.03.2021, si dhe në kalim të afateve të parashikuar në këtë vendim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në kushtet kur subjekti politik “Partia Aleanca Kombëtare” nuk kishte plotësuar dokumentacioni brenda afatit kohor, ka disponuar me vendimin nr. 166, datë 18.03.2021, duke vendosur:

“1.Refuzimin e listave shumëemërore të Partisë Aleanca Kombëtare, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve”.

Ky vendim rezulton të jetë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së.

6. Paditësi nuk e kundërshtuar vendimin nr. 166, datë 18.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve pranë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS).

7. Partia Aleanca Kombëtare i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, duke paraqitur fillimisht një ankim me shkrim.

8. Duke konstatuar te meta në ankimin e paraqitur, Gjyqtari relator i kësaj çështjeje në bazë të neneve 153, 154 të Kodit Zgjedhor vendosi t’i kërkojë ankuesit të plotësojë të metat e ankimit të paraqitur për gjykim në Kolegjin Zgjedhor dhe të regjistruar me numrin 7 regj. them, datë 06.04.2021, duke i caktuar si afat, jo më vonë se 24 orë para datës së caktuar për shqyrtimin gjyqësor të çështjes,(data 12.04.2021, ora 14.00).

9. Në datë 09.04.2021, pala paditëse depozitoi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor kërkesëpadinë me palët, objektin dhe bazën ligjore të sipërpërmendur.

Pretendimet e palës paditëse.

10. Pala paditëse pretendon se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në kundërshtim me ligjin ka refuzuar regjistrimin e subjektit politik Partia Aleanca Kombëtare në Zgjedhjet Parlamentare të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

Pretendohet se veprimet e kryera nga KQZ janë në shkelje të nenit 65 të Kodit Zgjedhor në të cilën përcaktohet se çdo parti politike ka të drejtën që të shprehë interes për tu regjistruar si subjekt zgjedhor pranë KQZ, jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve.

Partia politike “Aleanca Kombëtare e Shqipërisë” në datën 01.04.2021 i është drejtuar KQZ për të marrë një informacion zyrtar mbi kërkesën e partisë politike për regjistrim në zgjedhjet e 25 Prillit 2021.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në shkelje të ligjit, nuk i ka bërë me dije ankuesit, i cili ka shprehur interes dhe ka dorëzuar dokumentacionin për tu bërë pjesë e zgjedhjeve të përcaktuara me Dekret Presidenti në 25 Prill 2021.

Pala paditëse pretendon gjithashtu se, vendimi nr. 166, datë 18.03.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me të cilin është vendosur refuzimi i listave shumëëmërore të Partisë Aleanca Kombëtare, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, është një akt administrativ i kundraligjshëm dhe duhet shfuqizuar nga gjykata dhe duhet të detyrohet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të regjistrojë listat shumëëmërore të kandidatëve për deputetë të paraqitura nga pala paditëse.

Pala paditëse pretendon se nuk ka marrë dijeni për vendimin nr. 166, datë 18.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

11. Në mbështetje të kërtimeve në padi, pala paditëse ka paraqitur si provë:

- Procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve të kandidimit.
- Deklarata e datës 12.02.2021 e palës paditëse drejtuar KQZ-së.
- Kallëzim penal i datës 31.12.2019 drejtuar SPAK;
- Kërkesë e datës 16.05.2020 drejtuar Avokates së Popullit;
- Kërkesë e datës 12.04.2020 drejtuar KLGJ-së;
- Shkresa e titulluar ``njoftim`` i datës 15.07.2019 drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
- Kërkesë e datës 11.08.2016 drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë;
- Shkresën ``kthim përgjigje`` të datës 01.09.2020 të Avokatit të Popullit;
- Kërkesë e datës 03.06.2020 drejtuar ILD-së.
- Shkresa e titulluar ``njoftim`` e datës 13.12.2020 drejtuar Ministres së Drejtësisë.
- Shkresa e titulluar ``njoftim`` e datës 25.12.2020 drejtuar KQZ-së.
- Shkresa e datës 01.04.2021 drejtuar KQZ-së.

Prapësimet e palës së paditur.

12. Gjatë gjyqimit pala e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve prapësoi duke pretenduar se listat shumëëmërore të Partisë Aleanca Kombëtare nuk kanë përmbushur kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Po ashtu u parashtrua sepadaia është paraqitur jashtë afateve ligjore dhe në këto kushte u kërkuar rrëzimi i padisë.

13. Pala e paditur përparaqiti në gjykim: vendimin Nr. 166, datë 18.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendimin Nr. 139, datë 11.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendimin Nr. 78, datë 15.02.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe tre procesverbalet e seancave të zhvilluara në KQZ ku janë marre tre vendimet e sipërpërmendura.

II DISPOZITA LIGJORE TË ZBATUESHME:

Kodi Zgjedhor.

Neni 21

Kompetencat e KAS

1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, KAS-i ushtron këto kompetenca:
b) shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit;

Neni 63

Subjektet zgjedhore dhe kandidatët

1. Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.

Neni 145

“E drejta e ankimit në gjykatë”

1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.

Neni 158

Llojet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor

1. Në varësi nga çështjet në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos:
 - a) pushimin e gjykimit;
 - b) gjykimin e çështjes në themel; ose
 - c) detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim.
2. Pushimi i gjykimit vendoset kur Kolegji Zgjedhor konstaton se ankimi është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara në këtë Kod ose për mungesë kompetence. Kur Kolegji Zgjedhor vendos mungesën e kompetencës, ia dërgon çështjen organit kompetent.
3. Me gjykimin e çështjes në themel, Kolegji Zgjedhor vendos pranimin e plotë apo të pjesshëm të padisë ose rrëzimin e plotë apo të pjesshëm të saj.
4. Kolegji Zgjedhor vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim, në zbatim të pikës 2 të nenit 145 të këtij Kodi. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor cakton afat të prerë për marrjen e vendimit jo më të gjatë se 10 ditë.
5. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor është i formës së prerë. Ndaj tij nuk bëhet ankim.

Kodi i Procedurës Civile

Neni 299

Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur:

- c). Gjykata konstaton se çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si edhe kur padia nuk mund të ngrihej ose gjykimi nuk mund të vazhonte. Kur këto shkaqe konstatohen nga gjykatat më të larta, ato prishin vendimin e gjykatave më të ulëta dhe vendosin pushimin e gjykimit.

III. VLERËSIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYOËSOR.

1. Kolegji Zgjedhorevidenton se në nenin 21/1, shkronja ``b`` të Kodit Zgjedhor parashikohet një ndër kompetencat e KAS, që ështëshqyrtimi dhe zgjidhja në rrugë administrative ankesave ndaj akteve të Komisionerit.
2. Në nenin 63 të Kodit Zgjedhor jepet e drejta e subjekteve zgjedhore të paraqesin një listë kandidatësh për regjistrim në KQZ, sipas rregullave të caktuara nëKodin .Zgjedhor.
3. Në nenin 64 të KoditZgjedhorparashikohet procedura e regjistrimit si subjekt zgjedhor dhe afati i paraqitjes së kërkesës për regjistrim.
4. Në nenin 145 të K.Zgjedhor parashikohet e drejta e subjekteve zgjedhore të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda afatit 5 ditor nga shpallja e tyre, kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato çënojnë interesat e tyre të ligjshme, por këtë ankim kanë të drejtë tabëjnë vetëm pasi kanë ezauruar rrugën administrative të ankimimit në KAS sipas nenit 21/1, pika ``b`` të K.Zgjedhor.
5. Në nenin 152 të K.Zgjedhor parashikohet afati kohor 5 ditor për bërjen e ankimit në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimeve të KQZ, afat i cili fillon nga dita e shpalljes së vendimit nga KQZ.
6. Në nenin 158 të K.Zgjedhor parashikohen llojet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor. Një ndër vendimet që jep Kolegji Zgjedhor është pushimi i gjykimit. Ky vendim jepet midis të tjerave edhe në rastet kur ankimi është paraqitur në Kolegjin Zgjedhor jashtë afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk shqyrton në themel çështjen objekt gjykimi, por me konstatimin e faktit se ankimi është paraqitur jashtë afatit ligjor vendos me vendim jopërfundimtar pushimin e gjykimit të çështjes.
7. Paraqitja në afat e ankimit kundër vendimeve të KQZ është një kusht procedural për shqyrtimin në themel të çështjes objekt gjykimi.
8. Në nenin 299 të K.Pr.Civile parashikohen rastet kur gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Një ndër rastet kur gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes është rasti kur padia nuk mund të ngrihej.
9. Një ndër rastet kur padia nuk mund të ngrihej është rasti kur paditësi nuk ka ezauruar rrugën administrative të ankimimit përpara se ti drejtohet me padi gjykatës. Ezaurimi i rrugës administrative të detyrueshme është një kushtprocedural për shqyrtimin në themel të çështjes objekt gjykimi.
10. Lidhur me çështjen objekt gjykimi Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se jemi në kushtet kur duhet vendosur pushimi i gjykimit të çështjes objekt gjykimi pa shqyrtuar në themel pretendimet e paditësit. Referuar nenit 158/1, pika ``b``, nenit 158/2 të K.Zgjedhor dhe nenit 299, pika ``c`` të K.Pr.Civile, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se pala paditëse nuk ka ezauruar rrugën administrative të ankimimit në KAS për të kundërshtuar vendimin Nr.166, datë 18.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përpara se ti drejtohet me këtë padi Kolegjit Zgjedhor. Nëpërmjet këtij vendimi të Komisionerit Shtetëror tëZgjedhjeve është vendosur refuzimi i listave shumëemërore të Partisë Aleanca Kombëtare, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Është pikërisht ky vendim qëçenon interesat e palës paditëse, sipas pretendimeve të shfaqura në gjykim nga pala paditëse. Pala paditëse kishte të drejtë ta kundërshtonte këtë vendim në

KAS brenda tre ditëve nga shpallja e tij, gjë që pala paditëse nuk e ka bërë. Në këtë rast ai vendim ka marrë formë të prerë. Në një situatë të tillë pala paditëse nuk mund të kundërshtojë në Kolegjin Zgjedhor drejtpërdrejtë këtë vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Sipas nenit 21/1, pika ``b`` të Kodit Zgjedhor është KAS organi brenda KQZ-së që shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit.

11. Gjithashtu gjykata vlerëson se jemi në kushtet e një padie që nuk mund të ngrihet në kuptim të nenit 299 pika ``c`` të K.Pr.Civile në kushtet kur pala paditëse nuk ka ezauruar rrugën administrative të ankimimit të parashikuar në ligj sa më sipër u përmend.
12. Pretendimi i palës paditëse se nuk ka marrë dijeni për vendimin nr. 166, datë 18.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është një pretendim i pabazuar, pasi vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve rezulton se janë publikuar në faqen zyrtare të Web-it të KQZ-së.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor bazuar në nenin 158/2 të K.Zgjedhor, nenin 299 pika ``c`` të K.Pr.Civile

VENDOSI

1. Pushimin e gjykimit të çështjes të paraqitur në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor të regjistruar me Nr.7 regj.them, datë regj.06.04.2021.
 2. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës paditëse.
 3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
- U shpall sot më datë 12.04.2021 në Tiranë.

GJYQTAR

GJYQTARE

GJYQTAR

ASIM VOKSHI ESMERALDA ÇEKA (XHILI) GENTIAN MEDJA

GJYQTARE

EDLIRA PETRI

GJYQTAR

SOKOL IBI

SEKRETARE

ERJONA TORBA

Shpenzimet gjyqësore:

Taksë Pulle: 3000 lekë

Totali: 3000 lekë (të parapaguara nga paditësi)